Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 02-954
Datë: 08.10.2026

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060, për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak (UA Nr. 31/2014, data 05.09.2014), dhe Udhëzimit Administrativ për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr.09/2019, data 18.06.2019), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur më datë 07.10.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet Qendra për Aftësim Profesional (QAP) në Pejë për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data **29.09.2025 deri më 29.09.2028**, për zbatimin e procesit të Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP), për kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

1.1. Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit dhe Ujësjellësit, Niveli III i (KKK), Iloji: Kualifikim Kombëtar Profesional D, me gjithsej 14 kredi. Institucioni mund të realizojë procesin e Njohjes së Mësimit Paraprak për një vit kalendarik me kapacitet maksimal deri në 60 kandidatë.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së **Qendrës për Aftësim Profesional (QAP) në Pejë** për akreditimin e institucionit për zbatimin e procesit të Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP), si dhe rekomandimeve të dala nga raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit dhe validimin e kualifikimit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipi i ekspertëve, pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit më datë 27.03.2026, për kualifikimin **"Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit dhe Ujësjellësit"**, Niveli III sipas KKK-së, me gjithsej 14 kredi, realizoi vizitën në institucion më datë 07.04.2026.

Ekipi i ekspertëve ka vlerësuar se QAP Pejë ka bazë të mjaftueshme dokumentare, institucionale dhe procedurale për zbatimin e procesit të NjMP-së. Gjithashtu, është rekomanduar që përmes NjMP-së të trajtohen deri në 5 kandidatë në muaj, me një kapacitet të përgjithshëm prej 60 kandidatëve në vit.

Këshilli Drejtues i AKK-së, gjatë vendimmarrjes për akreditimin e QAP Pejë për zbatimin e NjMP-së, ka marrë parasysh faktin se institucioni ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm dhe ka dëshmuar kapacitete të përshtatshme institucionale, profesionale, materiale dhe infrastrukturore për realizimin e procesit.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha **vlerësim pozitiv** dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK-së, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. *Qendrës për Aftësim Profesional (QAP) në Pejë;*
2. *Arkivit të AKK-së.*

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD-së së AKK-së